



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË
REPUBLIKËN ARABE TË EGJIPTIT**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit me Republikën Arabe të Egjiptit, Ministria e Arsimit të Lartë të Egjiptit ofron 8 (tetë) bursa studimi (5 bursa për studime universitare dhe 3 bursa për studime pasuniversitare) për kandidatë shqiptarë, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në universitetet publike egjiptiane, për vitin akademik 2017-2018.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të dorëzojnë **me postë** pranë Drejtorisë së Integritimit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dokumentet sipas listës në vijim:

Për studime universitare:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku të specifikohet dega e studimit;
2. Vërtetimin e notave për tri vitet e shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
3. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
4. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
5. Dëshminë e Penalitetit;
6. 4 fotografi

Për studime pasuniversitare:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku të specifikohet fusha e studimit;
2. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku aplikanti ka studiuar;
3. Kopjen e noterizuar të diplomës që vërteton mbarimin e programit të nivelit të parë të studimeve universitare (Bachelor) ose të nivelit dytë të studimeve (Master Profesional/Master i Shkencave);
4. 1-2 letra rekomandimi nga shkolla ose vendi i punës, në rast se aplikanti është i punësuar;
5. Letrën e interesit ose një plan studimi për programin e studimit;
6. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
7. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;;
8. Dëshminë e Penalitetit;

9. 4 fotografi

Krahas bursave të mësipërme, Universiteti “Al-Azhar” me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit të Lartë të Egjiptit ofron, gjithashtu, 3 (tre) bursa për studime islamike, ndërsa Institutet “Al Azhar” ofrojnë 1 (një) bursë studimi për vitin akademik 2017-2018.

Kandidatët për studime universitare dhe pasuniversitare do t’i nënshtrohen vitit përgatitor të gjuhës arabe.

Bursa mbulon shpenzimet e ushqimit, të akomodimit dhe tarifën e shkollimit. Ndërsa shpenzimet udhëtimit duhet të mbulohen nga vetë kandidatët.

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën angleze ose arabe, si dhe të legalizuara nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Afati i fundit për aplikim është data **18 qershor 2017**.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE